

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna Hani i Elezit	
---	--	---

**MARRËVESHJE PËR SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE LOKALE
 GJATË SEZONIT VEROR DHE DIMËROR DHE PUNËVE TJERA TË
 SPECIFIKUARA NË KËTË MARRËVESHJE**

Data: 20.11.2020

02 8557 2020



- **Komuna Hani i Elezit:** Adresa; rr. “Nuri Bushi ” nr 2, objekti i Komunës, Komuna Hanit të Elezit, të cilën e përfaqëson, z. **Rufki Suma** - Kryetar i Komunës.
Në tekstin e mëtejme : Porositësi i shërbimeve.
- **NPL “Pastrimi” SH.A.** Adresa; rr. Dëshmorët e Kombit ,pa Nr. në Han të Elezit, Kosovë, me nr.të biznesit-**811167271**, e përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv NPL “Pastrimi” SH.A z. Irfan Suma, në tekstin e mëtejme : Kryesi i Shërbimeve.

Në mbështetje të nenit 58, pika b, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, nenit 9 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L -042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5 paragrafi 9 i Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrjen e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit si dhe si dhe nenit 4, nenit 45 si dhe 52 pika 51.2,51.3 dhe nenit 14 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit **Nr 01 nr i faqes 7703** të datës **25.10.2018** arrihet marrëveshja.

Duke marrë parasysh konsideratat dhe kushtet e premtimet reciproke të parashtruara këtu, personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Kontrate kryerjen e shërbimeve i identifikuar si, **“Kryesi i Shërbimeve”** dhe personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Kontrate si **“Porositësi i Shërbimeve”** bien dakord si vijon:

Mbi kryerjen e shërbimeve të pastrimit të rrugëve të qytetit gjatë sezonit veror dhe dimëror , heqjen e deponive ilegale, mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe të qytetit , mirëmbajtjen e hapësirave publike (kositjen e parqeve, rrëmihjen e drunjëve dekorativ, ujtijen e tyre, pastrimin dhe fshirjen e qytetit dhe vendbanimeve tjera sipas nevojës, pastrimin e proejëve Rezhancës, seqishtë, Dimcë, Tunelin e mbyllur në lagjen e Re , ndrrimin e kapakëve të kanalizimit fekal dhe atmosferik, mbjelljen e luleve në ambient të jashtëm etj..).

1. PËRKUFIZIMET

Në këtë marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

MARRËVESHJE- Pajtimi i vullnetit ndërmjet “kryesit të shërbimeve” dhe “porositësit të shërbimeve” me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin sipas marrëveshjes së arritur;

PASTRIMI – nënkupton pastrimin e rrugëve të qytetit gjatë sezonit veror dhe dimëror në pjesën lindore nga hekurudha, në rrugët: "Dëshmorët Kombit", Xhemsedin Suma "Nuri Bushi" "Isa Berisha" "Martirët Bushi" "Izet Bushi" "Dheu i Bardhë" "Imer Vila" "Lidhja e Prizerenit" "Pashtriku" "Kodra e trimave" "Nehat Curri" "Martirët e Dërmjakut" "Hasan Prishtina" "Dituria" "Driton Loku" "Gafurr loku" "Mërgimtarët" "Kushtrimi i Lirisë" "Udha e shkronjave" "Rezistenca" "Dardania" "Eksodi 99" "11 Qershori", "Adem Jashari", "Isen Suma", pastrimin dhe mirëmbajtjen e drujve dekorativ si dhe mirëmbajtjen e proit të Dimcës.

Pjesa Perëndimore nga hekurudha:-në rrugët "Lepenci", "Suad Brava", "Arbëria", "UÇK" "Brigada 164" "Kepi i Shqipes", "Foleja e UÇK-së", "Shtigjet e UÇK-Së", "Dëshmorët e Krivenikut", "Ilaz Thaçi", "Qemajl Thaçi", "Baki Krasniqi", "29 Marsi", "Mali i Artë", "Veli Ballazhi", "Qëndresa", "Naim Frashëri", "7 Marsi", "Vlora", "Ismajl Qemajli", "Veteranët e UÇK-së", "Sharri", "Jatakët e Lirisë", "17 Shkurti", "Sami Frashëri", "TMK", "Feriz dhe Xhevdet Guri", "Pavarësia", "Liria" "28 Nëntori", "Flakadanët e Lirisë", "29 Gushti", "Dëshmorët e Lirisë", "Suad Brava", "26 Shkurti", "Epopeja e UÇK-së" Po ashtu pjesë e marrëveshjes është edhe bartja e mbeturinave dhe pastrimi i deponive ilegale në depon legale, pastrimin dhe mirëmbajtjen e proejëve nga vërshimet si :.Proi i Rezhancës, Seqishtës.

AFAT - Ka kuptimin e dhënë në Nenin 2.1

KRYESI I SHËRBIMEVE - Do të thotë : KRM "Pastërtia" SH. A.

POROSITËSI I SHËRBIMEVE - Do të thotë: Komuna e Ferizajt

KRM "PASTËRTIA" SH.A - Person juridik i autorizuar për ofrimin e shërbimeve të lartëcekura.

SHËRBIM PUBLIK - Shërbimet e kryera me pagesë për mirëmbajtjen e hapësirave publike sipas kësaj marrëveshje.

ÇMIMI I SHËRBIMEVE : Ka kuptimin e çmimores së shërbimeve

VLERA E ÇMIMEVE - Çmimi i caktuar sipas Llojit të shërbimit, sipas sasisë dhe tarifave të përcaktuara në aneksin e marrëveshjes.

PERSONAT KONTAKTUES: ka kuptimin e personit me të cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e mirëfilltë të kësaj kontrate.

Monitorimi, akti i vëzhgimit dhe mbajtjes se evidencave për atë vëzhgim; ose përkujdesja:

përcjellja: mbajtja nën vëzhgim apo kontrollimi i zakonshëm për një qëllim të veçantë.

Raportimi - përgatitja e raportit (eve) të standardizuara nga ofrues i shërbimit për komunën në mënyrë të rregullt.

2. AFATI I BASHKËPUNIMIT

2.1 Kjo marrëveshje fillon në datën **20.11.2020**, dhe vlen me nënshkrimin e të dyja palëve kontraktuese dhe është e vlefshme për një periudhë kohore dymbëdhjetë (12) mujore, deri me **19.11.2021**, me mundësi vazhdimi, përveç rastit kur është fjala për zgjidhje të parakohshme të kësaj marrëveshje të lidhur në mes palëve kontraktuese.

2.2. Zgjidhja e marrëveshjes është e mundur edhe nëse dispozitat ligjore mbi shërbimet e tilla e parashohin një mundësi të tillë.

2.3. Personat Kontaktues, për porositësin e shërbimeve do të jetë: z. **Refet Kalisi**, e-mail :

refet.kalisi@rks-gov.net tel+383 044 225 281, dhe nga kryesi i shërbimeve, z. **Irfan Suma**, nr. tel; +383 (0) 044 472042, Kryeshef Ekzekutiv i NPL "Pastrimi" SH.A.

3. DETYRIMET E PALËVE

3.1. Palët kontraktuese janë marrë vesh që lënda e kontratës të jetë: **Mbi kryerjen e shërbimeve të pastrimit të rrugëve të qytetit gjatë sezonit veror dhe dimëror , heqjen e deponive ilegale, mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe të qytetit , mirëmbajtjen e hapësirave publike (kositjen e parqeve, ujitjen e tyre, rre mihjen e drunjëve dekorativ,ujitje e tyre, pastrimin dhe fshirjen e qytetit dhe vendbanimeve tjera sipas nevojës), mirëmbajtjen e prrojëve: Prroi i Rezhancës, Dimcës , Seqishtës dhe tuneli i mbyllur në lagjen e Re etj..**

3.2. Palët kontraktuese janë marrë vesh që kryesi i shërbimeve do të bëjë mirëmbajtjen e hapësirave publike të cekura në këtë marrëveshje, kurse porositi i shërbimeve për kryerjen e punëve do të bëjë pagesën sipas fletë dërgesave, faturave dhe çmimoreve së përcaktuar me këtë marrëveshje.

3.3 Çmimet për kryerjen e shërbimeve do të jenë si vijon:

3.3.1 Pastrimi i hapësirave në rrugët e qytetit dhe sheshet dhe hapësirave tjera publike, do të llogaritet dhe kompensohet me metër gjatësi sipas llojit të shërbimit siç janë Larja speciale, spërkatja dhe fshirja, si dhe me ton për heqjen dhe bartjen e mbeturinave nga deponitë ilegale.

3.3.2 Shërbimet dhe pastrimi i këtyre hapësirave publike nënkupton: **pjesën Lindore nga hekurudha** në rrugët: ""Dëshmorët Kombit", Xhemsedin Suma "Nuri Bushi" "Isa Berisha" "Martirët Bushi" "Izet Bushi" "Dheu i Bardhë" "Imer Vila" "Lidhja e Prizerenit" "Pashtriku" "Kodra e trimave" "Nehat Curri" "Martirët e Dërmjakut" "Hasan Prishtina" "Dituria" "Driton Loku" "Gafurr loku" "Mërgimtarët" "Kushtrimi i Lirisë" "Udha e shkronjave" "Rezistenca" "Dardania" "Eksodi 99" "11 Qershori", "Adem Jashari", "Isen Suma".

".

Pjesa Perëndimore nga hekurudha:-në rrugët "Lepenci", "Suad Brava", "Arbëria", "UÇK" "Brigada 164" "Kepi i Shqipësis", "Foleja e UÇK-së", "Shtigjet e UÇK-Së", "Dëshmorët e Krivenikut", "Ilaz Thaçi", "Qemajl Thaçi", "Baki Krasniqi", "29 Marsi", "Mali i Artë", "Veli Ballazhi", "Qëndresa", "Naim Frashëri", "7 Marsi", "Vlora", "Ismajl Qemajli", "Veteranët e UÇK-së", "Sharri", "Jatakët e Lirisë", "17 Shkurti", "Sami Frashëri", "TMK", "Feriz dhe Xhevdet Guri", "Pavarësia", "Liria" "28 Nëntori", "Flakadanët e Lirisë", "29 Gushti", "Dëshmorët e Lirisë", "Suad Brava", "26 Shkurti", "Epopeja e UÇK-së" Bartja e mbeturinave ilegale ne depon legale do të bëhet sipas nevojës në tërë territorin e komunës.

3.3.3 Mbi Kryerjen e Shërbimeve të pastrimit të rrugëve të qytetit gjatë sezonit Veror dhe Dimëror bartja e mbeturinave ilegale do të kompensohet sipas tarifës së përcaktuar në aneksin e marrëveshjes.

3.3.4 Hapësirat të cilat duhet të pastrohen janë: **pjesën Lindore nga hekurudha** në rrugët: Dëshmorët Kombit", Xhemsedin Suma "Nuri Bushi" "Isa Berisha" "Martirët Bushi" "Izet Bushi" "Dheu i Bardhë" "Imer Vila" "Lidhja e Prizerenit" "Pashtriku" "Kodra e trimave" "Nehat Curri" "Martirët e Dërmjakut" "Hasan Prishtina" "Dituria" "Driton Loku" "Gafurr loku" "Mërgimtarët" "Kushtrimi i Lirisë" "Udha e shkronjave" "Rezistenca" "Dardania" "Eksodi 99" "11 Qershori", "Adem Jashari", "Isen Suma"

3.3.5 Pjesa Perëndimore nga hekurudha:-në rrugët "Lepenci", "Suad Brava", "Arbëria", "UÇK" "Brigada 164" "Kepi i Shqipësisë", "Foleja e UÇK-së", "Shtigjet e UÇK-Së", "Dëshmorët e Krivenikut", "Ilaz Thaçi", "Qemajl Thaçi", "Baki Krasniqi", "29 Marsi", "Mali i Artë", "Veli Ballazhi", "Qëndresa", "Naim Frashëri", "7 Marsi", "Vlora", "Ismajl Qemajli", "Veteranët e UÇK-së", "Sharri", "Jatakët e Lirisë", "17 Shkurti", "Sami Frashëri", "TMK", "Feriz dhe Xhevdet Guri", "Pavarësia", "Liria" "28 Nëntori", "Flakadanët e Lirisë", "29 Gushti", "Dëshmorët e Lirisë", "Suad Brava", "26 Shkurti", "Epopëja e UÇK-së"

3.3.6 Bartja e mbeturinave nga deponitë ilegale nga hapësirat publike në hapësirën- vendin e caktuar nga porositësi i shërbimeve.

3.3.7 Shuma e çmimeve do të llogaritet sipas tarifës dhe çmimit për metër gjatësi të përcaktuar me aneksin e marrëveshjes .

3.3.8. Kryesi i shërbimeve obligohet të kryejë shërbimet e parapara me këtë marrëveshje kurse për ato shërbime të përgatis raport të punëve kurse porositësi i shërbimeve duhet të bëjë pranimin e atyre punëve përmes librit të pranimit.

3.3.9 Kryesi i shërbimeve obligohet që të bëjë verifikimin se a përputhen të dhënat e shënuara në librin e pranimit me të dhënat e shënuara në fletë dërgesa dhe fatura dhe të shënojë tarifën apo çmimin për secilën dërgesë.

3.3.10. Porositësi i shërbimit obligohet që të mbikëqyr punët e kryera përmes organit mbikëqyrës dhe atë: **1. Kujtim Dernjani** - Shef i sektorit të Shërbimeve publike **2. Fatbardha Bushi**- Inspektore sanitare dhe e ambientit, **Xhemshit Kalisi** – Inspektor i ndërtimit..

3.3.11 Kryesi i shërbimeve dhe Porositësi i shërbimit obligohen që të kryejnë punët në përputhje të legjislacionit në fuqi dhe elementeve që parasheh kjo marrëveshje.

3.3.12 Porositësi i shërbimit pagesën e çdo shërbimi të kryer nga kryesi i shërbimit do ta bëjë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dorëzuar nga porositësi i shërbimit.

3.3.13 Palët kanë arritur marrëveshjen, se porositësi i shërbimeve ka të rezervuar të drejtën se me një aneks kontratë të bëjë zgjerimin e llojit të shërbimeve, në pajtim të plotë me kryesin e shërbimeve e cila aneks marrëveshje do të jetë pjesë përbërëse e marrëveshjes bazë.

4. KUSHTET E PAGESËS

4.1 Kryesi i shërbimeve për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj kontrate përmes faturës ja faturon tarifën në fund të muajit për muajin paraprak në pajtim me tarifën e paraparë në aneks marrëveshje.

4.2 Faturimi do të bëhet sipas ofertës së prezantuar dhe në përputhje me çmimoren e aneksit të marrëveshjes.

4.3. Në rastet ku gjatë afatit kontraktues me ndonjë vendim institucional nga porositësi i shërbimeve bën ndryshim të tarifave dhe çmimeve, kryesi i shërbimeve obligohet që të veproj sipas çmimeve dhe tarifave të cilat i aprovon porositësi i shërbimeve.

5. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

5.1 Marrëveshja hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme në afat prej dymbëdhjet (12) muajve, me mundësi vazhdimi,

5.2. Para skadimit të afatit të marrëveshjes 30 ditë përpara duhet të shqyrtohet mundësia e vazhdimit të marrëveshjes dhe bashkëpunimit, me kërkesën paraprake me shkrim për vazhdim nga ana e porositësit të shërbimit.

5.3. Palët e marrëveshjes mund të zgjidhin marrëveshjen edhe para përfundimit të afatit në pikën 2.1. duke e njoftuar njëra-tjetrën se nuk dëshirojnë ta vazhdojnë bashkëpunimin me kërkesën me shkrim 30 ditë përpara.

5.4. Secila palë mund të ndërpresë njëanshëm marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve, brenda afatit të marrëveshjes, kurdo që e vlerëson se ka efekte negative afariste, duke njoftuar njëra-tjetrën me shkrim brenda afatit prej 15 ditësh.

6. PËRGJEGJËSIA

6.1. Kryesi i shërbimeve do t'i kryejë gjitha shërbimet në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet publike dhe plotësimet e tjera si dhe aneks marrëveshjen.

6.2 Kryesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar, keq shfrytëzim ose keqpërdorim prej anëtarëve të personelit të tij, të natyrës penale, qoftë ky i preکشëm ose i

paprekshëm në secilin prej rasteve të lartpërmendura që ndodh gjatë përmbushjes ose në lidhje me përmbushjen e kësaj marrëveshje.

Kryesi i Shërbimeve nuk mban përgjegjësi nëse këto janë të natyrës që përshkruhet në Nenin 7 (Forcë Madhore).

7. FORCA MADHORE

7.1 Nëse, në çdo kohë, gjatë afatit të kësaj marrëveshje përmbushja plotësisht ose pjesërisht nga secila palë e çdo detyrimi sipas kësaj marrëveshje pengohet ose vonohet për shkak të luftës, luftës civile, armiqësisë, akteve të armikut publik, rebelimit, revolucionit, fuqisë ushtarake ose të uzurpimit, shqetësimeve civile, demonstratave ose kërcënimeve të menjëhershme lidhur me gjithë si më lartë, sabotazhit, zjarrit, përmytjes, shpërthimeve, epidemive, kufizimeve për shkak të karantinës, shqetësimeve në furnizime nga burime normalisht të besueshme (ku përfshihen por jo vetëm elektricitet, ujë, naftë dhe të ngjashme), greva, përjashtime, vendime qeveritare ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të palës në fjalë (këtu e më poshtë e përmendur si “ndodhia”), atëherë përmbushja e këtyre detyrimeve do të falet në masën që u pengua ose u vonua dhe pala e prekur ka marrë njoftim për këtë ndodhi nga pala tjetër brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e ndodhisë duke pasur parasysh që ngjarja e çdo ndodhie nuk justifikon asnjë detyrim të secilës palë për të kryer pagesa. Asnjëra palë, për shkak të ndodhisë, nuk ka të drejtë ta zgjidh këtë kontrate ose të ngre pretendime për dëme kundër palës tjetër në lidhje me mos-përmbushjen ose vonesën në përmbushje. Përmbushja e detyrimeve të cenuara duhet të rifillojë sapo të jetë praktike pas përfundimit ose pushimit të ndodhisë në fjalë. Nëse përmbushja tërësisht ose pjesërisht e ndonjë detyrimi sipas kësaj marrëveshje vonohet për shkak të ndonjë ndodhie të tillë për një periudhë që tejkalon tre (3) muaj, palët do të takohen dhe rishikojnë në mirëbesim dëshirueshmërinë dhe kushtet për zgjidhjen e marrëveshjes.

8. MARRËVESHJA E PLOTË

8.1 Palët pohojnë dhe bien dakord se gjithë marrëveshjet dhe mirëkuptimet mes tyre marrin fund që prej datës efektive të kësaj kontrate: me kusht, që të gjitha shumat që përbëjnë detyrim ndaj secilës palë sipas marrëveshjes së mëparshme mbeten ende detyrime dhe të pagueshme.

9. LIGJI DHE JURIDIKSIONI

9.1 Kjo marrëveshje udhëhiqet sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, dhe kompetente për juridiksionin e saj është Gjykata Themelore e Ferizajt dega në Kaçanik.

9.2 Në rast të çdo mosmarrëveshjeje që lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen ose interpretimin e kësaj marrëveshjeje, palët bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes do ta marrë Gjykata kompetente e Ferizajt dega në Kaçanik.

9.3 Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet në tre (3) kopje origjinale, një (1) për porositësin e shërbimeve,(2) për kryesin e shërbimeve,(3) për arkivin e Komunës.

- Në vazhdimësi gjeni të bashkangjitur aneksin e marrëveshjes me specifikat e shërbimit në aneksin 1.

Komuna Hani i Elezit
Kryetar i Komunës

Z. Rufki Suma



NPL "Pastrimi" SH.A

Kryeshf Ekzekutiv

Z. Irfan Suma

